

Projekti: “Ndërtimi i kapaciteteve në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm të kapitalit në Maqedoninë e Veriut”

Fusha e Aktivitetit IV - Zhvillimi dhe realizimi i aktiviteteve për ndërtimin e kapaciteteve për Ndryshimet Klimatike dhe për Punë dhe Politikë Sociale

Plani i veprimit për të mbështetur zhvillimin e punësimit të gjelbër, të mençur klimatik, me ndjeshmëri gjinore dhe inkluziv në gjithë sektorët kryesorë të ekonomisë

Eksperti Nacional
Suzana Ignjatović Aleksova

Eksperti ndërkombëtar
Magdalena Hoerst

gusht, 2024

Përmbajtja

Lista e akronimeve	3
Përmbledhje ekzekutive	5
1. Hyrje	5
1.1. Informacionet bazë mbi kontekstin ekonomik dhe mjedisor të Maqedonisë së Veriut... 5	
1.2. Përmbledhje e Kontributeve të përcaktuara nacionale dhe rëndësia e tyre për planin e veprimit..... 6	
2. Objektivat..... 8	
2.1. Objektivat kryesore për zhvillimin e punësimit të gjelbër, të mençur klimatik dhe inkluziv..... 8	
2.2. Harmonizimi i këtyre objektivave me synimet dhe strategjitë nacionale afatgjata klimatike. 9	
3. Fushëveprimi dhe Qasja 10	
3.1. Përcaktimi i sektorëve kryesorë që do të synohen me planin e veprimit..... 10	
3.2. Metodologjitë dhe kornizat që do të përdoren për zbatimin e planit të veprimit..... 10	
3.3. Si integrohet plani i veprimit me politikat dhe kornizat strategjike ekzistuese. 11	
4. Angazhimi i palëve të interesit..... 12	
4.1. Identifikimi i aktorëve kryesorë dhe roleve të tyre..... 12	
4.2. Strategjia për angazhimin e palëve të interesit gjatë fazave të planifikimit dhe zbatimit. 14	
5. Qeverisja dhe Korniza institucionale për zbatimin e Planit të Veprimit..... 15	
6. Treguesit e performancës dhe monitorimi i zbatimit të planit të veprimit..... 19	
6.1. Treguesit kryesorë të performancës për matjen e progresit drejt synimeve të Planit të Veprimit. 19	
6.2. Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit. 21	
7. Resurset financiare dhe Mobilizimi..... 22	
7.1. Pasqyrë e kërkesave buxhetore..... 22	
7.2. Strategjitë për mobilizimin e resurseve financiare duke përfshirë burimet e mundshme të financimit 23	

8. Menaxhimi i rreziqeve dhe zbutja e tyre	24
Shtojca.....	Error! Bookmark not defined.

Lista e akronimeve

ALMPAT	Masat, Politikat dhe Shërbimet Aktive të Tregut të Punës
AP	Plani i Veprimit
EA	Agjencia për Punësim
EE	Efikasiteti Energjetik
ENDC	Kontributet e Forcuara të Përcaktuara në Nivel Nacional
BE	Bashkimi Evropian
GCF	Fondi i Gjëlber i Klimës
MEP	Ministria për Ekonomi dhe Punë
MPSDR	Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë
MMJPH	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
PKV-të	Planet Nacionale për Adaptim
NDC-të	Kontributet e Përcaktuara në Nivel Nacional
MKD	Republika e Maqedonisë së Veriut
KKS	Komisioni Këshillimor Strategjik
ESHS	Enti Shtetëror për Statistikë
SDG-të	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara



Përmbledhje Ekzekutive

Objektivi i Planit të Veprimit është përkrahja e procesit të aktiviteteve të ndërtimit të kapaciteteve lidhur me ndryshimet klimatike në sektorin e punës dhe mbrojtjes sociale.

Përfshirja do t'i paraqesë masat për lehtësimin e vendeve të gjelbra të punës, punësimin e mençur klimatik dhe inkluziv në sektorët kryesorë ekonomikë në vend.

Maqedonia e Veriut i është përkushtuar SDG-së 8 dhe konkretisht, objektivit 8.3: Promovimi i politikave të orientuara drejt zhvillimit që mbështesin aktivitetet produktive, krijimin e vendeve të dinjitetshme të punës, afarizmin, kreativitetin dhe inovacionin, si dhe të inkurajojë formalizimin dhe rritjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, edhe nëpërmjet qasjes në shërbimet financiare.

Raporti i Tretë Informativ Dyvjeçar për Ndryshimet Klimatike tregon se masat e propozuara zbutëse mund të krijojnë midis 5,309 dhe 7,848 vende të gjelbra pune në vitin 2030 sipas skenarëve të ndryshëm të vlerësimit. Masat që kontribuojnë në pjesën më të madhe në numrin e vendeve të reja të gjelbra të punës janë: rinovimi i ndërtesave ekzistuese për banim (42%), ndërtimi i shtëpive pasive (21%), kolektorët termikë diellorë (8%) dhe (burimet e rinovueshme të energjisë) BRE pa stimuj (6%) në vitin 2035. Të paktën 27% e numrit maksimal të vendeve të punës do të dedikohen për gratë.¹ Përbushja e kësaj kërkesë për fuqi punëtore të kualifikuar dhe dinamika e saj me kalimin e kohës kërkon rregullime në politikat për arsimin dhe tregun e punës dhe zhvillimin e politikave të këtylla të reja.

Megjithatë, ka një mospërputhje midis kërkesës së paraparë për punë ekologjike dhe programeve për arsim/trajnim si dhe politikave të punës në dispozicion. Investimi i ulët në kapitalin njerëzor përkthehet në pabarazi dhe mungesë mundësisish për qytetarët për arritjen e potencialit të tyre të plotë.

1. Hyrje

1.1. Informacionet bazë mbi kontekstin ekonomik dhe mjedisor të Maqedonisë së Veriut

Maqedonia e Veriut është shtet pa dalje në det në Evropën Juglindore, i karakterizuar nga peizazhe të ndryshme nga rajonet malore deri te luginat pjellore. Me një popullsi prej rreth 2.1 milion banorësh, vendi po kalon nga një ekonomi e bazuar në bujqësi në ekonomi më të

¹Raportet e përditësuara dyvjeçare për ndryshimet klimatike janë mund t'i gjeni këtu- [Klimatski Promeni](#)

larmishme dhe më të industrializuar. Sektorët kryesorë ekonomikë përfshijnë bujqësinë, industrinë, shërbimet dhe teknologjitë e informacionit dhe komunikimit.

Pavarësisht progresit ekonomik, Maqedonia e Veriut përballet me sfida të mëdha mjedisore, si ndotja e ajrit dhe ujit, shpyllëzimi dhe çështje për menaxhimin me mbeturinat. Mbështetja e madhe në resursin e thëngjillit për prodhimin e energjisë në mënyrë të konsiderueshme kontribuon për emetimet e gazrave serë (GHG), duke imponuar nevojën për veprim urgjent në drejtim të burimeve më të pastra dhe më të qëndrueshme për energji.

Konteksti i ndryshimit të klimës: Ndryshimet klimatike paraqesin një kërcënim të konsiderueshëm për stabilitetin socio-ekonomik të Maqedonisë së Veriut. Vendi përjeton rritje të temperaturave, ndryshim të modeleve të reshjeve dhe ngjarje ekstreme më të shpeshta të motit, duke ndikuar negativisht në bujqësi, resurset ujore dhe shëndetin publik. Adresimi i këtyre sfidave kërkon një qasje të koordinuar që integron rezistencën klimatike në politikat nacionale dhe planifikimin ekonomik.

Si një palë e jo-Aneksit I të Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) dhe nënshkruese e Marrëveshjes së Parisit, Maqedonia e Veriut është zotuar të zvogëlojë emetimet e saj të CO₂ nga lëndët djegëse fosile me 51% deri në vitin 2030 krahasuar me nivelet e vitit 1990. Ky objektiv ambicioz është pjesë e Kontributeve të Përcaktuara Nacionale të zgjeruara të vendit (NDC).

1.2. Përmbledhje e Kontributeve të Përcaktuara Nacionale dhe rëndësia e tyre për planin e veprimit

Kontributet e Përcaktuara Nacionale të Maqedonisë së Veriut (NDC-të) e përkufizojnë zotimin e vendit për të luftuar ndryshimet klimatike duke u fokusuar në reduktimin e emetimeve të gazrave serë (GHG) dhe rritjen e rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike. Si pjesë e Marrëveshjes së Parisit, Maqedonia e Veriut është zotuar të reduktojë emetimet e CO₂ nga lëndët djegëse fosile me 51% deri në vitin 2030 krahasuar me nivelet e vitit 1990.

Me NDC-të, prioritet u kushtohet disa sektorëve kryesor, duke përfshirë furnizimin me energji, ndërtesat dhe transporti, pasi këta janë kontribuesit kryesorë në emetimet e GS-ve në vend. Objektivat e përcaktuara në NDC-të theksojnë një kalim drejt burimeve të rinovueshme të energjisë, rritjen e efikasitetit të energjisë dhe përvetësimin e praktikave të qëndrueshme në aktivitete të ndryshme ekonomike.

Plani i Veprimit synon harmonizimin dhe përkrahje të NDC-ve të Maqedonisë së Veriut duke nxitur zhvillimin e punësimit të gjelbër, të mençur klimatik dhe inkluziv. Ky harmonizim është thelbësor

për të siguruar që strategjitë e punësimit jo vetëm të kontribuojnë në rritjen ekonomike, por edhe t'i përkrahin synimet klimatike të vendit.

Fushat kryesore ku Plani i Veprimit ndërthuret me NDC-të përfshijnë:

Promovimi i Vendeve të gjelbra të punës: Duke inkurajuar krijimin e vendeve të punës në sektorë si energjia e rinovueshme, bujqësia e qëndrueshme dhe ndërtimet ekologjike, Plani i veprimit drejtpërsëdrejti i mbështet objektivat zbutëse të NDC-ve.

Punësim i mençur klimatik: Integrimi i qëndrueshmërisë klimatike në politikat e tregut të punës siguron që strategjitë e punësimit të jenë të qëndrueshme dhe të kontribuojnë për ekonominë me karbon të ulët që është paraparë në NDC-të. Kjo përfshin promovimin e vendeve të punës që fokusohen në masat e përshtatjes, të tilla si përmirësimi i menaxhimit me ujërat dhe rritja e qëndrueshmërisë së praktikave bujqësore.

Punësimi inkluziv: Garantimi që mundësitë për punësim janë në dispozicion për gratë, të rinjtë dhe komunitetet e marginalizuara korrespondon me aspektet e përfshirjes sociale të NDC-ve. Kjo qasje promovon rritje të barabartë dhe shfrytëzon potencialin e plotë të fuqisë punëtore për t'i mbështetur veprimet klimatike.

Ngritja e kapaciteteve: Forcimi i kapaciteteve të institucioneve publike, sektorit privat dhe organizatave të shoqërisë qytetare është qenësor për zbatimin efektiv të NDC-ve. Plani i Veprimit përfshin iniciativa për ndërtimin e aftësive dhe njohurive të nevojshme për të përkrahur punësimin e gjelbër dhe inkluziv.

Politika dhe Mbështetja Legjislative: Rishikimi dhe përditësimi i politikave të punës dhe çështjeve sociale për inkorporimin e masave të përshtatjes dhe zbutjes ndaj ndryshimeve klimatike siguron që kuadri ligjor dhe rregullator t'i mbështesin objektivat e NDC-ve. Kjo përfshin përcaktimin e udhëzimeve për bizneset që të përfshijnë praktika dhe teknologji të qëndrueshme.

Edukimi dhe trajnimi: Zhvillimi i programeve të arsimit dhe trajnimit profesional që pajisin fuqinë punëtore me aftësi për punë ekologjike është në përkrahje të synimeve për qëndrueshmëri afatgjatë të NDC-ve. Duke nxitur një fuqi punëtore të ditur dhe të kualifikuar, Maqedonia e Veriut mund t'i përmbush më mirë objektivat e saj klimatike.

Integrimi i NDC-ve me Strategjitë Nacionale

Plani i veprimit është gjithashtu në përputhje me strategjitë nacionale më të gjera, siç është Strategjia Afatgjatë e Veprimit për Klimën, Objektivat Nacionale për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG-të) dhe Programi i Reformës Ekonomike (PRE). Duke siguruar koherencë midis Planit të veprimit dhe këtyre kornizave strategjike, Maqedonia e Veriut mund t'i shfrytëzojë sinergjitë dhe të arrijë ndikim më të madh në politikat e saj për klimën dhe për punësim.

Si përmbledhje, Plani i veprimit jo vetëm që mbështet objektivat specifike të përcaktuara në NDC-të e Maqedonisë së Veriut, por gjithashtu kontribuon në zhvillimin e përgjithshëm të qëndrueshëm të vendit. Duke promovuar punësimin të gjelbër, të mençur klimatik dhe inkluziv. Plani i veprimit ndihmon në krijimin e një ekonomie rezistente që është e përgatitur për t'u bërë ballë sfidave nga ndryshimet klimatike.

2. Objektivat

2.1. Objektivat kryesore për zhvillimin e punësimit të gjelbër, të mençur klimatik dhe inkluziv

Objektivi kryesor i këtij plani për veprim është të nxitet zhvillimi i punësimit të gjelbër, të mençur klimatik dhe inkluziv në sektorët kryesorë ekonomikë në Maqedoninë e Veriut. Kjo i përfshin objektivat specifike të mëposhtme:

Promovimi i vendeve të gjelbra të punës: Rritja e krijimit dhe cilësisë së vendeve të gjelbra të punës në sektorë të tillë si energjia e rinovueshme, bujqësia e qëndrueshme dhe ndërtimet miqësore për mjedisin, në përputhje me zotimet e vendit sipas Marrëveshjes së Parisit dhe NDC-ve të saj.

Punësimi i mençur klimatik: Integrimi i qëndrueshmërisë klimatike në politikat e tregut të punës për të siguruar që strategjitë e punësimit mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm dhe kalimin në një ekonomi me karbon të ulët.

Punësimi inkluziv: Të sigurohet që mundësitë për punësim të jenë në dispozicion për të gjitha grupet demografike, duke përfshirë gratë, të rinjtë dhe komunitetet e marginalizuara, duke promovuar në këtë mënyrë barazinë sociale dhe rritjen inkluzive.

Ngritja e Kapaciteteve: Forcimi i kapaciteteve të institucioneve publike, sektorit privat dhe organizatave të shoqërisë qytetare për të mbështetur dhe zbatuar iniciativat e punësimit të gjelbër dhe inkluziv.

Edukimi dhe Trajnimi: Zhvillimi dhe zbatimi i programeve për arsim dhe trajnim profesional që i pajisin fuqinë punëtore me aftësitë e nevojshme për punësim të gjelbër dhe të mençur klimatik.

Politika dhe Mbështetja Legjislative: Rishikimi dhe përditësimi i politikave ekzistuese të punës dhe çështjeve sociale për të përfshirë masat e përshtatjes dhe zbutjes ndaj ndryshimeve klimatike, duke promovuar praktika të qëndrueshme në të gjithë sektorët.

2.2. Harmonizimi i këtyre objektivave me synimet dhe strategjitë nacionale afatgjata klimatike

Synimet e përcaktuara në këtë Plan veprimi korrespondojnë ngushtë me objektivat dhe strategjitë afatgjata nacionale klimatike të Maqedonisë së Veriut, të cilat janë të theksuara në disa dokumente dhe iniciativa kryesore. Harmonizimi siguron që zhvillimi i punësimit të gjelbër, të mençur klimatik dhe inkluziv t'i mbështesë objektivat më të gjera klimatike dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Kontributet e përcaktuara në nivel nacional (NDC): Plani i veprimit i mbështet drejtpërdrejt angazhimet e Maqedonisë së Veriut sipas Marrëveshjes së Parisit duke promovuar punësimin në sektorë kritikë për arritjen e objektivave NDC, siç janë energjia e rinovueshme, efikasiteti energjetik dhe bujqësia e qëndrueshme.

Strategjia Afatgjatë e Veprimit për Klimën: Objektivat janë në përputhje me Strategjinë Afatgjatë për Veprimin Klimatik, e cila thekson rëndësinë e integritit të perspektivave klimatike në të gjitha aspektet e zhvillimit ekonomik, duke përfshirë tregun e punës.

Objektivat Nacionale për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG-të): Plani i veprimit kontribuon në arritjen e SDG-ve, veçanërisht Objektivin 8 (Punë e Denjë dhe Rritja Ekonomike), Objektivin 13 (Veprimi për Klimën) dhe Objektivin 5 (Barazia Gjinore).

Programi i Reformës Ekonomike (ERP): Objektivat janë në përputhje me ERP-në, që i përshkruan masat për të rritur rezistencën ekonomike dhe për të promovuar rritjen e qëndrueshme përmes punësimit të gjelbër dhe inkluziv.

Strategjia për Rritje të Gjelbër: Plani i veprimit e mbështet Strategjinë e Rritjes së Gjelbër duke nxitur një mjedis të përshtatshëm për investime të qëndrueshme dhe inovacione në teknologjitë e gjelbra.

Duke siguruar që synimet e Planit të veprimit të korrespondojnë me këto strategji dhe objektivat nacionale, Maqedonia e Veriut mund të krijojë një qasje koherente dhe të integruar ndaj zhvillimit të qëndrueshëm, duke i shfrytëzuar sinergjitë ndërmjet veprimeve klimatike dhe politikave të punësimit për të arritur qëndrueshmëri dhe prosperitet afatgjatë.

3. Fushëveprimi dhe Qasja

3.1. Përcaktimi i sektorëve kryesorë që do të synohen me planin e veprimit

Plani i veprimit synon të fokusohet në disa sektorë që janë qenësor për arritjen e punësimit të gjelbër, të mençur klimatik dhe inkluziv. Në këta sektorë përfshihen:

Energjia e Rinovueshme: Promovimi i zhvillimit dhe përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë si energjia diellore, eolike dhe hidrike. Ky sektor është qenësor për reduktimin e emetimeve të CO₂ dhe krijimin e vendeve të qëndrueshme për punë.

Bujqësia e Qëndrueshme: Forcimi i praktikave bujqësore për të qenë më të qëndrueshme dhe më rezistente ndaj ndryshimeve klimatike. Kjo nënkupton promovimin e bujqësisë organike, shfrytëzimin efikas të ujit dhe teknikat e ruajtjes së tokës.

Ndërtime ekologjike: Inkurajimi i ndërtimit të objekteve me efikasitet energjetik dhe rinovimi i strukturave ekzistuese për t'i përmbushur standardet më të larta mjedisore. Ky sektor ofron mundësi të konsiderueshme për vende të gjelbra pune.

Menaxhimi dhe riciklimi i hedhurinave: Përmirësimi i sistemeve të menaxhimit të hedhurinave dhe rritja e normave të riciklimit për të zvogëluar ndikimin mjedisor dhe për të krijuar vende të gjelbra pune në ekonominë e gjelbër.

Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK): Përdorimi i TIK-ve për të mbështetur zgjidhjet dhe inovacionet inteligjente klimatike. Kjo përfshin zhvillimin e teknologjive që përmirësojnë efikasitetin energjetik dhe i reduktojnë emetimet.

3.2. Metodologjitë dhe kornizat që do të përdoren për zbatimin e planit të veprimit

Zbatimi i Planit të Veprimit do të përfshijë disa metodologji dhe korniza për të siguruar efektivitetin dhe përafrimin e tij me objektivat nacionale:

Konsultimi dhe angazhimi me palët e interesuara: Angazhimi i aktorëve kryesorë, duke përfshirë ministrinë qeveritare, organizatat e shoqërisë qytetare (OSHQ-të), përfaqësuesit e sektorit privat dhe publikun e gjerë. Kjo do të sigurojë që Plani i veprimit të jetë gjithëpërfshirës dhe t'i pasqyrojë nevojat dhe kapacitetet e të gjithë aktorëve përkatës.

Ngritja e Kapaciteteve dhe Programet e Trajnimit: Zhvillimi dhe realizimi i programeve të trajnimit për ngritjen e kapaciteteve të institucioneve publike, sektorit privat dhe organizatave të

shoqërisë qytetare. Kjo përfshin trajnimin mbi praktikat inteligjente klimatike dhe krijimin e vendeve të gjelbra për punës.

Rishikimet e politikave dhe legislative: Rishikimi dhe përditësimi i politikave dhe legjislacionit ekzistues për t'i integruar perspektivat klimatike. Kjo do të sigurojë që kuadri rregullator t'i përkrahë synimet e Planit të veprimit dhe të inkurajojë praktika të qëndrueshme.

Monitorimi, Raportimi dhe Vlerësimi (MRE): Krijimi i sistemeve të fuqishme për MRE për mbikëqyrjen e zbatimit dhe ndikimit të Planit të Veprimit. Kjo përfshin vendosjen e treguesve kryesorë të performancës (KPI) dhe kryerjen e vlerësimeve të rregullta për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm.

Partneritetet Publiko-Private (PPP): Inkurajimi i bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik dhe privat për të nxitur inovacionin dhe investimet në teknologjitë dhe praktikat e gjelbra. Kjo do të ndihmojë në mobilizimin e resurseve dhe ekspertizës së nevojshme për një zbatim të suksesshëm.

3.3. Si integrohet plani i veprimit me politikat dhe kornizat strategjike ekzistuese

Plani i veprimit është hartuar në mënyrë që plotësisht të integrohet me politikat ekzistuese nacionale dhe kornizat strategjike për të siguruar koherencë dhe sinergji. Pikat kryesore të integritimit përfshijnë:

Harmonizim me kontributet e përcaktuara në nivel nacional (NDC): Plani i veprimit i mbështet synimet e NDC-ve duke promovuar vende të gjelbra të punës dhe praktika inteligjente klimatike nëpër sektorët themelorë. Ky harmonizim e ndihmon Maqedoninë e Veriut t'i përmbushë angazhimet e saj ndërkombëtare klimatike sipas Marrëveshjes së Parisit.

Mbështetje për Strategjinë Afatgjatë të Veprimit Klimatik: Objektivat dhe veprimet e përcaktuara në Planin e Veprimit janë në përputhje me Strategjinë Afatgjatë të Veprimit Klimatik, e cila thekson integrimin e perspektivave klimatike në zhvillimin ekonomik.

Kontributi në Objektivat Nacionale për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG): Plani i Veprimit kontribuon në arritjen e SDG-ve, veçanërisht ato që ndërlidhen me punë të denjë dhe rritjen ekonomike (Objektivi 8), veprimin klimatik (Objektivi 13) dhe barazinë gjinore (Objektivi 5). Kjo siguron që plani i mbështet objektivat më të gjera të zhvillimit.

Integrimi me Programin e Reformës Ekonomike (ERP): Plani i veprimit korrespondon me ERP-në, në të cilin përshkruhen masat për të rritur rezistencën ekonomike dhe për të promovuar

rritjen e qëndrueshme. Duke nxitur punësimin e gjelbër dhe inkluziv, plani i mbështet objektivat e ERP-së.

Mbështetje për Strategjinë e Rritjes së Gjelbër: Plani i veprimit është hartuar për të nxitur një mjedis të favorshëm për investime të qëndrueshme dhe inovacione në teknologjitë e gjelbra, në përputhje me Strategjinë e Rritjes së Gjelbër.

Duke siguruar integrimin me këto politika dhe korniza strategjike ekzistuese, Plani i veprimit synon të krijojë një qasje koherente dhe të unifikuar për zhvillimin e qëndrueshëm, duke i shfrytëzuar sinergjitë ndërmjet veprimeve klimatike dhe politikave të punësimit për të arritur qëndrueshmëri dhe prosperitet afatgjatë për Maqedoninë e Veriut.

4. Angazhimi i palëve të interesit

4.1. Identifikimi i aktorëve kryesorë dhe roleve të tyre

Angazhimi efektiv i palëve të interesuara është thelbësor për zbatimin e suksesshëm të Planit të Veprimit. Palët kryesore të interesuara të përfshira janë ministritë dhe autoritetet qeveritare, organizatat e shoqërisë qytetare (OSHQ-të), përfaqësuesit e sektorit privat dhe partnerët ndërkombëtarë. Çdo palë e interesuar ka një rol specifik në nxitjen e punësimit të gjelbër, të mençur klimatik dhe inkluziv.

Ministritë e Qeverisë:

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë (MPSDR):

- Institucioni udhëheqës për integrimin e perspektivave të ndryshimeve klimatike në politikat e punës dhe çështjeve sociale.
- Institucioni përgjegjës për bashkërenditjen me ministritë e tjera dhe palët e interesuara për të siguruar koherencën e politikave.

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJPH):

- Ofron ekspertizë teknike për çështjet mjedisore dhe në lidhje me klimën.
- Siguron harmonizimin e Planit të Veprimit me politikat nacionale për klimën dhe angazhimet ndërkombëtare.

Ministria e Ekonomisë dhe Punës:

- Promovon iniciativat ekonomike të gjelbra dhe mbështet zhvillimin e vendeve të gjelbra të punës.
- Koordinon me sektorin privat për t'i inkurajuar praktikatat e qëndrueshme të afarizmit.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës:

- Integron ndryshimet klimatike dhe qëndrueshmërinë në kurrikulat arsimore.
- Mbështet programet e trajnimit profesional për zhvillimin e aftësive të gjelbra.

Organizatat e Shoqërisë Qytetare (OSHQ):

- Kanë një rol kritik në rritjen e ndërgjegjësimit për ndryshimet klimatike dhe në avokimin për politika inkluzive.
- Sigurojnë njohuri dhe mbështetje në terren për zbatimin e nismave të bazuara në komunitet.

Përfaqësuesit e sektorit privat:

- Thelbësorë për nxitjen e inovacionit dhe investimeve në teknologjitë e gjelbra dhe praktikatat e qëndrueshme.
- Bashkëpunojnë me qeverinë dhe OSHQ-të për krijimin e mundësive për punë dhe për promovimin e rritjes së qëndrueshme ekonomike.

Partnerët ndërkombëtarë:

- Këtu bëjnë pjesë organizatat sikur Fondi i Gjelbër i Klimës (GCF) dhe Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP).
- Sigurojnë mbështetje financiare dhe teknike për zbatimin e Planit të Veprimit.
- Lehtësojnë shkëmbimin e njohurive dhe krijimin e kapaciteteve.

Institucionet arsimore:

- Universitetet, qendrat e trajnimit profesional dhe institucionet kërkimore.
- Zhvillojnë dhe përpilojnë programe trajnimi për të pajisur fuqinë punëtore me aftësitë e nevojshme të gjelbra.

4.2. Strategjia për angazhimin e palëve të interesit gjatë fazave të planifikimit dhe zbatimit

Një strategji gjithëpërfshirëse për angazhimin e palëve të interesuara, me të cilën sigurohet që të gjitha palët përkatëse të përfshihen në fazat e planifikimit dhe zbatimit të Planit të Veprimit. Strategjia i përfshin komponentët kryesorë të mëposhtëm:

1. Hartëzimi dhe analiza fillestare e palëve të interesuara:
 - Identifikimi i të gjithë aktorëve përkatës dhe interesave, ndikimi dhe kapacitetet e tyre.
 - Zhvillim i analizës për t'i kuptuar rolet dhe kontributet potenciale të secilës palë të interesuar.
2. Krijimi i komisioneve dhe grupeve punuese me palët e interesuara:
 - Formim i komisioneve dhe grupeve punuese për të lehtësuar komunikimin dhe bashkëpunimin e rregullt ndërmjet palëve të interesuara.
 - Përfshirje e përfaqësuesve nga qeveria, OSHQ-të, sektori privat dhe institucionet arsimore në këto grupe.
3. Konsultimet dhe punëtoritë e rregullta:
 - Organizimi i konsultimeve dhe punëtorive në faza të ndryshme të hartimit dhe zbatimit të Planit të Veprimit.
 - Të shfrytëzohen këto platforma për të mbledhur të dhëna, për të ndarë progresin dhe për t'i adresuar shqetësimet nga palët të ndryshme të interesuara.
4. Komunikimi dhe ndarja e informacioneve:
 - Zhvillim i një plani për komunikim për t'i mbajtur të informuara palët e interesuara lidhur me progresin, arritjet kryesore dhe rezultatet nga Plani i Veprimit.
 - Shfrytëzimi i kanaleve të shumta (p.sh., takime, raporte, buletine, platforma onlajn) për të siguruar shpërndarje të gjerë dhe efektive të informacioneve.
5. Ngritja e Kapaciteteve dhe Trajnimit:
 - Të ofrohen programe të synuara trajnimi për të ndërtuar kapacitetin e palëve të interesuara për të mbështetur zbatimin e Planit të Veprimit.
 - Përqendrim në rritjen e aftësive në lidhje me praktikat inteligjente klimatike, krijimin e vendeve të gjelbra të punës dhe strategjitë gjithëpërfshirëse për punësim.
6. Mekanizmat për monitorim dhe dhënie të fidbekut:

- Krijimi i mekanizmave për monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të aktiviteteve për angazhimin e palëve të interesuara.
- Mbledhje e fidbekut nga palët e interesuara për t'i përmirësuar strategjitë e angazhimit dhe për t'u siguruar që nevojat dhe shqetësimet e tyre janë adresuar.

7. Partneritetet Publiko-Private (PPP):

- Promovim i PPP-ve për t'i shfrytëzuar resurset, ekspertizën dhe inovacionin nga sektori privat.
- Inkurajim i projekteve për bashkëpunim që kontribuojnë në qëllimet e Planit të Veprimit.

8. Bashkëpunimi Ndërkombëtar:

- Angazhim me partnerët ndërkombëtarë për të përfituar nga përvoja e tyre, mbështetja teknike dhe mundësitë për financim.
- Lehtësimi i shkëmbimit të njohurive dhe mësimin nga praktikat më të mira në vendet tjera.

Duke zbatuar këtë strategji gjithëpërfshirëse për angazhimin e palëve të interesuara, Planit i Veprimit ka për synim të sigurojë pjesëmarrje inkluzive, të nxisë bashkëpunimin dhe të zmadhojë efektivitetin e nismave të parapara në të. Kjo qasje do të ndihmojë në krijimin e një mjedisi mbështetës për zhvillimin e punësimit të gjelbër, të mençur klimatik dhe inkluziv në të gjithë Maqedoninë e Veriut.

5. Qeverisja dhe Korniza Institucionale për zbatimin e Planit të Veprimit

Zbatimi i Planit të Veprimit kërkon qeverisje të fuqishme dhe bashkërenditje institucionale. Një sfidë e rëndësishme e qeverisjes është në bashkërenditjen ndërmjet autoriteteve të shumta, secili me përgjegjësi të mbivendosura në fushën e ndryshimeve klimatike. Me rëndësi thelbësore është të sigurohet një bashkërenditje efektiv për tejkalimin e fragmentimit dhe për nxitjen e një qasjeje koherente ndaj veprimit klimatik dhe punësimit.

Seksioni në vijim ofron rolet dhe përgjegjësitë potenciale të palëve të interesuara për zbatimin e Planit të Veprimit. Ju lutemi të keni parasysh që rolet dhe përgjegjësitë e paraqitura mund të shërbejnë vetëm si sugjerime dhe parime udhëzuese jokonkrete. Rolet

dhe përgjegjësitë aktuale duhet të përcaktohen bashkërisht dhe për to të pajtohen të gjithë aktorët e përfshirë.

Institucioni	Roli	Përgjegjësia
Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë (MPSDR)	Institucioni udhëheqës për zbatimin e Planit të Veprimit.	<ul style="list-style-type: none"> Mbikëqyrja Strategjike: Siguron udhëheqje të përgjithshme dhe siguron integrimin e strategjive për punësimin inteligjent klimatik dhe inkluziv në politikat nacionale të punës. Bashkërenditja: Lehtësimi i bashkëpunimit ndërministror për të harmonizuar angazhimet e aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë Ministrinë e Ekonomisë, Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe të tjerë. Zbatimi: Mbikëqyrje e përfshirjes së programeve të trajnimit dhe iniciativave që mbështesin krijimin e vendeve të gjelbra të punës dhe ngritjen e aftësive të fuqisë punëtore në përputhje me veprimet e përshkruara në Planin e veprimit në formatin 'Excel'. Monitorimi dhe Vlerësimi: Krijimi i një sistemi të fuqishëm monitorimi për të gjurmuar progresin kundrejt treguesve kryesorë të performancës së specifikuar në Planin e Veprimit.
Agjencia për Punësim	Organi zbatues	<ul style="list-style-type: none"> Zbatimi: Mbikëqyrje e përfshirjes së programeve të trajnimit dhe e iniciativave që mbështesin krijimin e vendeve të gjelbra të punës si dhe ngritjen e aftësive të fuqisë punëtore në përputhje me veprimet e përshkruara në Planin e Veprimit në formatin 'Excel'. Monitorimi dhe Vlerësimi: Krijim i një sistemi monitorues për të mbikëqyrur progresin kundrejt treguesve kryesorë të performancës të specifikuar në Planin e Veprimit.
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJPH)	Ofron ekspertizë mjedisore dhe klimatike.	<ul style="list-style-type: none"> Harmonizimi i politikave: Sigurohet që Plani i Veprimit të jetë në përputhje me politikat nacionale klimatike dhe angazhimet ndërkombëtare, sikur Marrëveshja e Parisit dhe Kontributet e Përcaktuara Nacionale (NDC-të). Mbështetje Teknike: Ofron udhëzime teknike për integrimin e qëndrueshmërisë klimatike në strategjitë e punësimit dhe zbatimin e projekteve.

		<ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi Mjedisor: Monitoron ndikimin mjedisor të Planit të Veprimit dhe siguron përputhshmëri me normat mjedisore.
Ministria e Ekonomisë dhe Punës (MEP)	Mbështetja e zhvillimit ekonomik përmes krijimit të vendeve ekologjike të punës.	<ul style="list-style-type: none"> • Stimujt ekonomikë: Zhvillimi dhe promovimi i stimujve ekonomikë për bizneset që t'i përvetësojnë praktikrat e qëndrueshme dhe të krijojnë vende të gjelbra pune. • Angazhimi i sektorit privat: Lehtësimi i partneriteteve ndërmjet qeverisë dhe sektorit privat për t'i inkurajuar investimet në teknologjitë dhe praktikrat e gjelbra. • Mobilizimi i resurseve: Punë me institucionet financiare dhe donatorët ndërkombëtarë për të siguruar financim për projektet e parashikuara me Planin e Veprimit.
Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH)	Integrimi i arsimit dhe trajnimeve të zgjuara klimatike në kurrikulat.	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i kurrikulës: Punë me institucionet arsimore për të përfshirë trajnimin për aftësi të gjelbra në programet e arsimit profesional dhe të lartë. • Zbatimi i programit: Mbështetje të zhvillimit dhe përfshirjes së programeve specifike për trajnim që përputhen me nevojat e ekonomisë së gjelbër, siç është përshkruar në Planin e Veprimit në formatin 'Excel'. • Përkrahje kërkimore: Inkurajim i kërkimeve dhe inovacioneve në teknologjitë dhe praktikrat inteligjente klimatike.
Organizatrat e Shoqërisë Qytetare (OSHQ)	Përfaqësim për politika inkluzive dhe rezistente ndaj klimës.	<ul style="list-style-type: none"> • Angazhimi i komunitetit: Mobilizim i komuniteteve dhe ngritje e vetëdijes për mundësitë për vende të gjelbra të punës. • Mbështetje e zbatimit: Siguron mbështetje bazë për zbatimin e projekteve të bazuara në komunitet në suazat e Planit të Veprimit. • Përfaqësim i politikave: Siguron që Plani i Veprimit të përfshijë norma për grupet e marginalizuara dhe të cenueshme për të përfituar nga krijimi i vendeve të gjelbra të punës.
Përfaqësuesit e Sektorit Privat	Investim dhe përvetësim i praktikave të qëndrueshme që kontribuojnë në Planin e Veprimit.	<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i vendeve të punës: Bashkëpunim me qeverinë për të krijuar mundësi punësimiti në sektorë thelbësorë sikur energjia e rinovueshme dhe bujqësia e qëndrueshme. • Integrimi PKSH: Integrim i iniciativave inteligjente klimatike në programet për Përgjegjësi Shoqërore Korporative, duke kontribuar në objektiva më të gjera të Planit të Veprimit.



Partnerët Ndërkombëtarë	Sigurojnë mbështetje financiare dhe teknike për zbatimin e Planit të Veprimit.	<ul style="list-style-type: none"> • Financimi: Shfrytëzimi i resurseve financiare për zbatimin e projekteve dhe iniciativave thelbësore të parapara me Planin e Veprimit. • Asistenca Teknike: Ofron ekspertizë në fushat sikur hartimi, zbatimi dhe monitorimi i projektit. • Shkëmbimi i njohurive: Lehtësimi i shkëmbimit të praktikave më të mira nga iniciativat e ngjashme të vendeve tjera.
--------------------------------	--	---

Për të siguruar zbatimin e suksesshëm të Planit të Veprimit, sugjerohet që të krijohen disa mekanizma të fuqishëm. Këto mekanizma do të dizajnohen për të lehtësuar bashkërenditjen, monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm në të gjitha nivelet e zbatimit. Parimet e mëposhtme mund të përdoren si udhërrëfyes për ngritjen e strukturave funksionale drejtuese dhe qeverisëse për zbatimin e Planit të Veprimit.

Grupi punues ndërsektorial

Mund të përcaktohet një grup punues me dedikim, i përbërë nga përfaqësues të palëve kryesore të interesuara si Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Agjencia e Punësimit, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Ekonomisë dhe të tjerë. Ky grup punues do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e bashkërenditjes dhe zbatimit të Planit të Veprimit. Ky grup do t'i adresojë sfidat që shfaqen gjatë zbatimit dhe do të sigurojë që të realizohet harmonizimi me strategjitë nacionale. Grupi punues gjithashtu do të ketë rol vendimtar për të siguruar që të gjitha veprimet të jenë të sinkronizuara nëpër sektorët e ndryshëm, duke maksimizuar ndikimin e Planit të Veprimit.

Takimet mujore koordinuese

Takime të rregullta duhet të mbahen me të gjitha palët relevante, duke përfshirë ministrinë e qeverisë, organizatat e shoqërisë qytetare, përfaqësuesit e sektorit privat dhe partnerët ndërkombëtarë. Këto takime mujore do të shërbejnë si një platformë për të shqyrtuar progresin, për të diskutuar dhe për t'i zgjidhur sfidat si dhe për t'i bërë rregullimet e nevojshme në Planin e Veprimit.

Sistemi i centralizuar i monitorimit

Duhet të zhvillohet një sistem i centralizuar monitorimi për të ndjekur zbatimin e Planit të Veprimit. Ky sistem do të grumbullojë të dhëna për treguesit kryesorë të performancës (TKP) dhe do të sigurojë raporte të rregullta për Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale. Të dhënat e grumbulluara do të jenë vendimtare për vlerësimin e efektivitetit të Planit të Veprimit, identifikimin e fushave për përmirësim dhe sjelljen e vendimeve të bazuara në të dhëna. Sistemi i centralizuar

gjithashtu do të mundësojë gjurmimin në kohë reale të progresit, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie.

Partneritetet Publiko-Private (PPP)

Partneritetet Publiko-Private (PPP) do të jenë një mekanizëm thelbësor për shfrytëzimin e resurseve dhe të ekspertizës në zbatimin e Planit të Veprimit. Këto partneritete do të fokusohen në sektorë qenësorë si energjia e rinovueshme, ndërtimi i gjelbër dhe bujqësia e qëndrueshme. Duke nxitur bashkëpunimin midis qeverisë dhe sektorit privat, PPP-të do të ndihmojnë në nxitjen e inovacionit, sigurimin e financimit të nevojshëm dhe përshejtimin e tranzicionit drejt një ekonomie të gjelbër. Qeveria do të promovojë dhe mbështesë në mënyrë aktive këto partneritete, duke identifikuar rëndësinë e tyre në arritjen e synimeve të Planit të Veprimit.

6. Treguesit e performancës dhe Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit

6.1. Treguesit kryesorë të performancës për matjen e progresit drejt synimeve të Planit të Veprimit

Treguesit kryesorë të performancës (KPI) në vijim duhet të trajtohen si sugjerime, të cilat duhet të rafinohen dhe bëhen me marrëveshje me palët përkatëse të interesuara. Treguesit në seksionin vijues mund të japin udhëzime për procesin e përcaktimit të treguesve që do të përdoren për zbatimin e Planit të Veprimit. KPI-të mund të përdoren për të matur efektivitetin e planit në arritjen e objektivave të tij në sektorë të ndryshëm.

Tema / Veprimi	TKP	Synimi
Krijimi i vendeve të gjelbra të punës	Përqindja e vendeve të gjelbra të punës të plotësuar nga gratë, me fokus mbi inkluzivitetin.	Të sigurohet që të paktën 30% e vendeve të gjelbra të punës të plotësohen nga femrat, duke reflektuar theksin mbi barazinë gjinore.
Trajnim dhe Përsosje e shkathtësive	Numri i programeve për trajnim të zhvilluara dhe të zbatuara, së bashku me numrin e pjesëmarrësve.	Zbatimi i programeve për trajnim specifik për sektorë për vende të gjelbra të punës, me fokus të posaçëm në grupet e lëndueshme dhe përfaqësimin e drejtë gjinor në pjesëmarrje.

Zhvillimi i Shërbimeve Sociale	Numri i shërbimeve të reja sociale të zhvilluara dhe numri i ndërmarrjeve sociale të themeluara, me të dhëna të shpërndara për gjininë.	Rritja e numrit të ndërmarrjeve dhe shërbimeve sociale, posaçërisht ato që synojnë grupet në rrezik social.
Politika dhe Integrimi Strategjik	Numri i paraqitjeve publike, postimeve në mediat sociale dhe forma të tjera të komunikimit, të cilat zhvillohen për të promovuar Planin e Veprimit.	Zhvillimi i një komunikimi të gjerë publik për të ngritur vetëdijen lidhur me rëndësinë e shkathtësive dhe vendeve të gjelbra të punës dhe me përfitimet nga tranzicioni i gjelbër.
Angazhimi dhe ndërgjegjësimi i publikut	Numri i paraqitjeve publike, postimeve në mediat sociale dhe forma të tjera të komunikimit, të cilat zhvillohen për të promovuar Planin e veprimit.	Zhvillimi i një komunikimi të gjerë publik për të ngritur vetëdijen lidhur me rëndësinë e shkathtësive dhe vendeve ekologjike të punës dhe me përfitimet nga tranzicioni i gjelbër.
Rezultatet e Programit për Edukim dhe Trajnim	Numri i pjesëmarrësve në programet për edukim dhe trajnim në nivele të ndryshme.	Rritja e pjesëmarrjes në programet e trajnimit profesional dhe arsimit të lartë që fokusohen në aftësitë e gjelbra dhe sigurojnë që këto programe të jenë të arritshme për grupe të ndryshme studentësh.
Punësimi me ndjeshmëri gjinore	Përqindja e vendeve të gjelbra të punës të plotësuar nga femrat.	Të paktën 30% e vendeve të reja të gjelbra të punës do të plotësohen nga femrat deri në vitin 2030.
Programet për trajnim inteligjent klimatik	Numri i programeve të trajnimit të zhvilluara dhe të zbatuara.	Hartim i 10 programeve të reja për trajnim deri në vitin 2026.
Integrimi i politikave	Numri i politikave të rishikuara dhe të përditësuara për të përfshirë qëndrueshmërinë klimatike.	Përditësim i të paktën 5 politikave kryesore deri në vitin 2025.

6.2. Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit

Për të monitoruar në mënyrë efektive progresin e Planit të Veprimit, do të krijohet një kuadër gjithëpërfshirës për Monitorim dhe Vlerësim (M&E). Ky kuadër do të sigurojë që të gjithë KPI-të të monitorohen rregullisht dhe të bëhen të gjitha rregullimet që i nevojiten procesit të zbatimit. Parimet kryesore që janë paraqitur më poshtë mund të merren parasysh gjatë hartimit të një kuadri konkret për Monitorim dhe Vlerësim për zbatimin e tërë Planit të Veprimit ose veprimeve konkrete të përcaktuara në të. Çdo kuadër për Monitorim dhe Vlerësim që do të zhvillohet për Planin e Veprimit duhet të jetë i përafuar ose i integruar në sistemet ekzistuese të monitorimit tashmë në përdorim në institucionin kryesor të zbatimit, Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë (MPSDR).

Raportimi i rregullt

- Frekuenca: Raporte tremujore të parashtruara nga çdo institucion përgjegjës, duke e mbuluar progresin kundrejt KPI-ve.
- Subjektet përgjegjëse: Ministrinë dhe institucionet kryesore, duke përfshirë Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe Agjencinë e Punësimit.

Vlerësimet vjetore

- Përfshirja: Kryerja e vlerësimeve vjetore për të vlerësuar ndikimin e përgjithshëm të Planit të Veprimit, duke përdorur metoda sasiore dhe cilësore.
- Metodologjia: Përfshirje e sondazheve me palët e interesuara, vlerësimet e ndikimit dhe analizë e tendencave të tregut të punës në lidhje me vendet e gjelbra të punës.

Konsultime me palët e interesuara

- Qëllimi: Angazhimi i palëve të interesuara përmes konsultimeve të rregullta për të mbledhur fibdek dhe për t'u siguruar që Plani i Veprimit të përgjigjet ndaj nevojave dhe mundësive që do të shfaqen.
- Metoda: Organizim i punëtorive dhe forumeve për të diskutuar përparimin, sfidat dhe përmirësimet potenciale me përfaqësuesit qeveritarë, të sektorit privat dhe shoqërisë qytetare.

Sistemi i centralizuar i grumbullimit të të dhënave

- Funkzioni: Krijohet një sistemi i centralizuar i menaxhuar nga Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë për grumbullimin e të dhënave dhe analizimin e tyre në lidhje me Planin e veprimit.
- Burimet e të dhënave: Përfshijnë të dhëna nga institucionet arsimore, realizuesit e trajnimeve, ndërmarrjet shoqërore dhe palët e tjera të interesuara.

Procesi i përmirësimit të vazhdueshëm:

- Qasja: Zbatimi i një cikli të vazhdueshëm përmirësimi ku gjetjet nga aktivitetet e Monitorimit dhe Vlerësimit përdoren për të përmirësuar dhe forcuar strategjitë e Planit të veprimit.
- Integrimi i fidbekut: Të përdoret fidbeku nga vlerësimet vjetore dhe konsultimet me palët e interesuara për të bërë rregullime të përsëritura në planin.

7. Resurset financiare dhe Mobilizimi

Financimi ose buxhetimi i veprimeve të veçuara nuk ishte pjesë e diskutimeve gjatë punëtorive me palët e interesuara. Prandaj, nuk mund të bëhet asnjë propozim konkret buxhetor.

7.1. Pasqyrë e kërkesave buxhetore

Shpërndarja e fondeve:

Buxheti do të shpërndahet nëpër sektorë dhe iniciativa të ndryshme bazuar në rëndësinë e tyre strategjike dhe ndikimin potencial në përmbushjen e objektivave të Planit të Veprimit.

Fushat kryesore në të cilat nevojiten investime të konsiderueshme përfshijnë projektet e energjisë së rinovueshme, iniciativat e qëndrueshme bujqësore, programet e trajnimit për aftësi të gjelbra dhe themelimin e ndërmarrjeve shoqërore.

Fondet kontingjente:

Një pjesë e buxhetit do të rezervohet për shpenzime të paparashikuara që mund të ndodhin gjatë fazës së zbatimit. Kjo do të sigurojë që Plani i Veprimit të mbetet në rrugën e duhur edhe në rast të ballafaqimit me sfida të papritura.

Afati kohor i buxhetit:

Buxheti do të jetë i strukturuar në përputhje me afatin kohor të Planit të Veprimit, duke siguruar që fondet të jenë në dispozicion kur të nevojiten për të mbështetur zbatimin me kohë të nismave të ndryshme.

7.2. Strategjitë për mobilizimin e resurseve financiare duke përfshirë burimet potenciale të financimit

Për t'i siguruar resurset e nevojshme financiare për Planin e veprimit, do të miratohet një qasje e shumëfishtë për mobilizimin e resurseve. Kjo qasje do t'i shfrytëzojë burimet vendase dhe ndërkombëtare të financimit, duke siguruar që Plani i veprimit të jetë krejtësisht i financuar dhe i qëndrueshëm në afat të gjatë.

Fondi i Gjelbër Klimatik (GCF):

Roli: Fondi i Gjelbër Klimatik do të jetë burimi kryesor i financimit ndërkombëtar për Planin e Veprimit.

Strategjia: Përpilohen dhe parashtrihen projekt propozime të detajuara për të siguruar financimin nga GCF-ja për iniciativat kryesore sikur zhvillimi i energjisë së rinovueshme, bujqësia inteligjente klimatike dhe programet për zhvillimin e kapaciteteve.

Fondet Strukture dhe Investuese Evropiane (ESF+):

Roli: Megjithëse Maqedonia e Veriut aktualisht nuk kualifikohet për financim nga ESF, ekziston një mundësi për t'u akredituar në të ardhmen.

Strategjia: Shqyrtoni mundësitë për akreditim dhe zhvilloni një udhërrëfyes për qasjen në fondet e ESF+ për të mbështetur projektet afatgjata që kanë të bëjnë me zhvillimin e qëndrueshëm dhe punësimin e gjelbër.

Institucionet Financiare Ndërkombëtare (IFI):

Roli: Angazhim me IFI-të si Banka Botërore, Banka Evropiane për Rinovim dhe Zhvillim (BERZH) dhe të tjera për të siguruar bashkëfinancimin për projektet e mëdha.

Strategjia: Prezantoni iniciativat e Planit të veprimit para IFI-ve, duke vënë theks në përafrimin me objektivat globale klimatike dhe në potencialin për rezultate me ndikim të lartë.

Buxheti shtetëror dhe rialokimi:

Roli: Buxheti shtetëror do të jetë një burim thelbësor financimi për Planin e veprimit, veçanërisht për nismat vendase dhe projektet e sektorit publik.

Strategjia: Punoni me Ministrinë e Financave për të identifikuar linjat ekzistuese buxhetore që mund të rialokohen për të mbështetur zbatimin e Planit të veprimit, duke siguruar që projektet inteligjente klimatike të kenë prioritet në shpenzimet nacionale.

Partneritetet Publiko-Private (PPP):

Roli: PPP-të do të kenë një rol të rëndësishëm në mobilizimin e resurseve nga sektori privat.

Strategjia: Zhvillimi i mundësive tërheqëse për investime për kompanitë private në sektorët sikur energjia e rinovueshme, ndërtimi i gjelbër dhe bujqësia e qëndrueshme. Nxitja e investimeve private përmes lehtësimeve tatimore, subvencioneve dhe mekanizmave të tjerë financiarë.

Kontributet dhe grantet e donatorëve:

Roli: Donatorët ndërkombëtarë dhe organizatat që japin grante do të synohen për të ofruar fonde shtesë.

Strategjia: Ndërtimi i partneriteteve me organizata si UNDP, Bashkimi Evropian dhe donatorë dypalësh për të siguruar grante për projekte specifike sipas Planit të veprimit.

Mekanizmat inovativë të financimit:

Roli: Kërkoni mekanizma të ri dhe inovativë financimi sikur bonot e gjelbra, financimi klimatik dhe investimi me ndikim.

Strategjia: Ndërveproni me tregjet financiare dhe investitorët që janë të interesuar për zhvillim të qëndrueshëm me qëllim që të sigurohen burime shtesë financimi.

8. Menaxhimi i rreziqeve dhe zbutja e tyre

Adresimi i rreziqeve institucionale dhe financiare është vendimtar për suksesin e Planit të veprimit. Në këtë kapitull janë përshkruar rreziqet kryesore dhe strategjitë e propozuara për

zbutjen e tyre. Ushtrimi për vlerësimin e rreziqeve duhet të bëhet në mënyrë ideale për çdo veprim veçmas pasi të kalojë në fazën e zbatimit.

Lloji i rrezikut	Rreziku	Skenari	Zbutja
Rreziqet institucionale	Dështimet gjatë koordinimit	Mungesa e koordinimit ndërmjet ministrive dhe institucioneve.	Krijim i një grupi punues ndërsektorial për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të veprimit.
	Kufizimet e kapaciteteve	Kapacitete të kufizuara në institucionet për zbatimin e politikave të zgjuara klimatike.	Investim në programe për ngritjen e kapaciteteve dhe për asistencë teknike.
Rreziqet financiare	Mungesa në financim	Financimi i pamjaftueshëm për zbatimin e Planit të veprimit.	Diversifikim i burimeve të financimit dhe zhvillim i planeve të rezervë për mungesat buxhetore.
	Shpërndarje e gabuar e resurseve	Shfrytëzimi joefikas i fondeve të alokuara.	Zbatimi i procedurave të rrepta të monitorimit financiar dhe auditimit.

Shtojca

Shtojca – Plani i Veprimit për të mbështetur zhvillimin e punësimit të gjelbër, të mençur klimatik dhe inkluziv në sektorët kryesorë të ekonomisë, duke marrë në konsideratë ambiciet e NDC-ve.